

**Emri / Mbiemri** Arben Kraja  
**Atësia** Isa  
**Datëlindja** 20 Shtator 1964  
**Vendlindja** Shkodër  
**Statusi civil** I martuar  
**Adresa zyrtare** Rruga "Qemal Stafa", Nr. 1, Tiranë.

**Shtetësia** Shqiptare

## **EKSPERIENCA NË PUNË**

- **SHKURT 2018 – Aktualisht, Prokuror.**  
Ushtroj funksionin e prokurorit në Sektorin e Verifikimit të Integritetit të "Personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike", në zbatim të ligjit Nr.138/2015.

### ***Prokuroria e Përgjithshme***

- **QERSHOR 2013 – JANAR 2018, Prokuror.**  
Kam ushtruar funksionin e prokurorit pranë Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe detyra të tjera, të caktuara sipas ligjit organik të prokurorisë.

### ***Prokuroria e Përgjithshme.***

- **SHTATOR 2014 - JANAR 2015, Prokuror, Drejtues Seksioni (I komanduar).**

Kam ushtruar detyrën e Drejtuesit të Seksionit, i sapo krijuar, bazuar në ndryshimet e kompetencave në K.Pr.Penale në drejtim të organizimit të punës për ngritjen dhe funksionimin e sektorit.

***Seksioni Kundër Korrupsionit dhe Hetimit Aseteve Kriminale.***

***Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.***

- **TETOR 2009 - QERSHOR 2013, Prokuror, Drejtues Sektori.**

Kam ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtues i Sektorit të Hetimit Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit.

Sektori ka koordinuar punën e Njësive të Përbashkëta Hetimore, të ngritura në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë, Fier dhe Gjirokastrë.

Hetim të rasteve për juridiksion fillestar.

***Sektori Kundër Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë e Përgjithshme.***

- **SHTATOR 2007 – TETOR 2009, Prokuror, Drejtues Sektori.**

Kam ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtues i Sektorit Kundër Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit.

Sektori ka koordinuar punën e Njësive të Përbashkëta Hetimore Tiranë, me strukturat e tjera të përfshira në hetimin e rasteve të korrupsionit, krimin ekonomik dhe pastrimit të parave.

Hetim të rasteve për juridiksion fillestar.

***Sektori Kundër Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë e Përgjithshme.***

- **QERSHOR 2002 – SHTATOR 2007, Prokuror.**

Kam ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Hetim të rasteve për juridiksion fillestar.

Kontroll në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe detyra të tjera të caktuara nga ligji.

***Drejtoria e Hetimit dhe Kontrollit në Prokurorinë e Përgjithshme.***

- **MARS 2001 – MAJ 2002, Drejtor.**

Kam ushtruar detyrën e Drejtorit të Njesisë Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave.

Njësia Antikorrupsion e sapo krijuar ka përgatitur projekt strategjinë e parë të qeverisë kundër korrupsionit. Pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave, Njësia ka monitoruar zbatimin dhe koordinuar punën e strukturave të ekzekutivit në zbatim të saj.

***Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.***

- **SHTATOR 1997 - SHTATOR 2000, Zëvendëskryetar i Parë i KLSH-së.**

Kam ushtruar detyrën e Zëvendëskryetarit të Parë të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Sipas kompetencave ligjore kam kryer funksionin e zëvendës drejtuesit në institucion, me objekt pune menaxhimin e inspektorëve të KLSH në kontrollet e kryera për menaxhimin e fondeve publike nga administrata shtetërore.

***Kontrolli i Lartë i Shtetit.***

- **SHKURT 1995 - SHTATOR 1997, Prokuror.**

Kam ushtruar detyrën e prokurorit në Drejtorinë e Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme, duke kryer hetime për raste të ndryshme, kontroll në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe detyra të tjera të caktuara nga ligji.

***Prokuroria e Përgjithshme.***

- **MARS 1993 - JANAR 1995, Hetues.**

Kam ushtruar detyrën e hetuesit në Drejtorinë e Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme, duke kryer hetime për raste të ndryshme.

***Prokuroria e Përgjithshme.***

- **PRILL 1992 - SHKURT 1993, Jurist.**

Kam ushtruar detyrën e juristit pranë Degës së Policisë Financiare Shkodër, duke kryer detyra në përgatitjen e dokumentacionit dhe këshillimin e drejtuesit të degës nga ana juridike.

*Policia Financiare, Dega Shkodër.*

- **DHJETOR 1987 – MARS 1992, Hetues.**

Kam ushtruar detyrën e hetuesit në Hetuesinë e Rrethit Shkodër, duke kryer hetime të rasteve të ndryshme, bazuar në legjislacionin në fuqi.

*Hetuesia e Rrethit Shkodër.*

## **KURSE KUALIFIKIMI, TRAJNIME DHE EDUKIMI**

- Çertifikuar "Trajner në fushën e Antikorrupsionit dhe Mirëqeverisjes", nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike dhe Shkolla Italiane e Administratës Publike. (2016)
- Çertifikuar trajner në hartimin e Curriculum për trajnime në zbatim të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (nenet 5 dhe 6) nga Misioni OPDAT Kroaci dhe Ministria e Drejtësisë Kroate. Disa trajnime të zhvilluara në Dubrovnik gjatë viteve 2015 dhe 2016.
- Trajnim me temë "Korrupsioni, evidentimi dhe parandalimi", organizuar në Paris, nga Shkolla e Magjistraturës Francë. (2015)
- Trajnim me temë "Lufta kundër pastrimit të parave, mjetet e hetimit dhe bashkëpunim midis institucioneve të ndryshme", organizuar në Vlorë nga Komisioni Evropian dhe Shkolla e Magjistraturës. (2013)
- Trajnim me temë "Mbrojtja e të dhënave personale në sektorin gjyqësor", organizuar në Tiranë nga Komisioni Evropian. (2011)
- Çertifikuar trajner në fushën "Pastrimi i produkteve të veprës penale, korrupsioni dhe teknikat e hetimit të aseteve të krimit", nga Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian dhe Instituti për Qeverisje Basel (Internacional Centre for Asset Recovery). (organizuar në Tiranë dhe Strasbourg në vitin 2011)



- Trajnim me temë "Krimi kompjuterik", organizuar në Tiranë nga Zyra Tej-Oqeanike e Zhvillimit, Ndihmës dhe Trajnimit të Prokurorisë në Departamentin e Drejtësisë së SHBA dhe Shkolla e Magjistraturës së Shqipërisë. (2010)
- Trajnim me temë "Teknikat e hetimit të krimit financiar", organizuar në Tiranë nga Departamenti i Thesarit të SHBA. (2010)
- Trajnim i trajnerëve, organizuar në Tiranë nga Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian Tiranë. (2005)
- Pjesmarrës në "Internacional Visitor Program of the United States Department of State", me temë "Lufta kundër krimit financiar dhe pastrimit të parave në SHBA". (2004)
- Trajnim për "Korrupsionin në Administratën Publike", në Tiranë, organizuar nga Misioni OPDAT Tiranë. (2002)
- Trajnim për "Antikorrupsioni dhe OJQ", në Bullgari, organizuar nga USAID Albania. (2001)
- Trajnim për "Kontrollin Financiar", në Gjykatën e Llogarive Lisbonë, Portugali. (1998)

**1989 – 1992** Kam kryer studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.  
Diplomuar Jurist.

**1983 – 1987** Kam kryer studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë.  
Diplomuar Ekonomist për Ekonomi Politike.

## **GJUHË TË HUAJA**

*Anglisht*

*Italisht*

## **KOMPJUTER,**

Word, Excel, Power Point, Acces Outlook, Internet, e-mail.

## **2004 – 2012 dhe 2016 - Aktualisht,**

### ***Anëtar i delegacionit shqiptar në Komitetin Moneyval të Këshillit të Europës, Strasbourg.***

- ✓ Komiteti Moneyval është një komitet ekspertësh nga vendet e Këshillit të Europës, i krijuar në vitin 1997, për të bërë vlerësime të situatës në shtetet anëtare nëse është në përputhje me standartet ndërkombëtare të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe i rekomandon atyre marrjen e masave për përmirësimin e situatës dhe sjelljen e saj në raport me standartet ndërkombëtare.
- ✓ Në këtë kuadër kam marrë pjesë rregullisht në takimet periodike të këtij komiteti që zhvillohen në Strasbourg.

## **2008 - Aktualisht,**

### ***Përfaqësues i institucionit të prokurorisë shqiptare në rrjetin AFCOS.***

- ✓ AFCOS është strukturë e ngritur në vendet antarësuarë së fundi në BE dhe vendet candidate për antarësim në BE. Bazuar në Rregulloren 883/2013 të BE është duke u ngritur edhe në çdo vend antarë të BE. Kjo strukturë është ngritur dhe funksionon në ndihmë të OLAF (Zyra për Mbrojtjen e Interesave Financiare të BE) me qëllim koordinimin e punës ndërmjet strukturave ligjzbatuese në mbrojtje të ir teresave financiare të BE.
- ✓ Në kuadër të këtij rrjeti kam marrë pjesë në takimet periodike vjetore që janë zhvilluar në vende të ndryshme ku është ngritur ky rrjet.
- ✓ Nga viti 2017 rrjeti AFCOS është ngritur edhe në Shqipëri. Jam caktuar si përfaqësues i institucionit të prokurorisë në këtë rrjet.

## **2011 - 2013,**

### ***Drejtues Projekti Binjakëzimi, me objekt "Mbështetja e strukturave kundër pastrimit të parave dhe hetimit të krimit financiar në Shqipëri".***

- ✓ Projekt i financuar nga BE me objekt "Mbështetja e strukturave kundër pastrimit të parave dhe hetimit të krimit financiar në Shqipëri". Projekti është zbatuar nga Instituti Spanjoll i Studimeve Fiskale.
- ✓ Institucionet përfituese Prokuroria e Përgjithshme, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Agjensia për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara.
- ✓ Kohëzgjatja e projektit është nga Shkurti 2011 deri më Prill 2013.

#### **Objektivat kryesore :**

- ✓ Përmirësimi i koordinimit mes institucioneve përfituese, veçanërisht mes Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit;
- ✓ Forcimi i veprimit të Ligjit Antimafia përsa i përket parandalimit dhe konfiskimit të aseteve;

- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe veprimeve procedurale që kryejnë entet përfituese në identifikimin, gjetjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të paligjshme;
- ✓ Adoptimi i masave me qëllim uljen e përdorimit të parasë cash në treg;
- ✓ Përmirësimi i koordinimit ndërkombëtar në identifikimin, gjetjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të paligjshme;
- ✓ Përmirësimi i koordinimit mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, veçanërisht Njësive të Përbashkëta Hetimore.

**2009 – 2012**

***Përfaqësues i institucionit të prokurorisë në Komitetin Drejtues të Projektit PACA.***

- ✓ Projekti PACA i financuar nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës, është zbatuar nga Këshilli i Evropës (Divizioni i Krimit Ekonomik). Përfitues janë institucione të ndryshme në Shqipëri, ndër të cilat edhe prokuroria.
  - ✓ Kohëzgjatja e projektit nga Shtatori 2009 deri në Dhjetor 2012.
- Gjatë zbatimit të këtij projekti janë kryer një sërë aktivitetesh në lidhje me punën e prokurorisë si më poshtë :**
- ✓ Trajnime dhe vizita studimore, për prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, të organizuara në kuadër të projektit në fushën e krimit financiar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimit të organizuar.
  - ✓ Pregatitja e një grupi trajnuesish (prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore) të certifikuar nga Instituti i Bazelit në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, në fushën e hetimit të krimit financiar, pastrimit të parave dhe konfiskimit të aseteve që rrjedhin nga krimi organizuar.
  - ✓ Pregatitja nga ekspertët e projektit të një "Doracaku mbi trajnimin e trajnerëve".
  - ✓ Pregatitja nga ekspertët e projektit të një Manuali "Për bashkëpunimin ndërkombëtar në gjurmimin, identifikimin dhe kthimin e aseteve të krimit të rëndë dhe atij financiar".
  - ✓ Asistencë specifike në fushën e kuptimit dhe zbatimit të ligjit antimafia gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit.
  - ✓ Asistencë në hartimin e statistikave të unifikuara ndërmjet policisë, prokurorisë dhe gjykatave në fushën e hetimit të krimeve financiare, korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimit të organizuar në kuadër të zbatimit të 12 Rekomandimeve të BE për Shqipërinë.
  - ✓ Pregatitja e propozimeve për ndryshime kushtetuese në fushën e kufizimeve të imunitetit për funksionarët e lartë politikë.



## 2009 – 2011

### *Përfaqësues i prokurorisë në Grupin Ndërinstitucional të Punës për mbikqyrjen dhe sigurimin e mbarëvajtjes së procesit të zbatimit të projekteve të fazës së dytë të Marrëveshjes së Pragut të Programit të Sfidës së Llogarisë së Mijëvjeçarit (MCC) në Shqipëri.*

- ✓ Marrëveshja e Pragut të Programit të Sfidës së Llogarisë së Mijëvjeçarit (MCC) në Shqipëri, një projekt i financuar nga qeveria e SHBA. Komponenti nr.6 i projektit kishte objektiv mbështje për ngritjen dhe vënien në funksionim të gjashtë Njësive të Përbashkëta Hetimore pranë Prokurorive Shkodër, Durrës, Fier, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë, me qëllim rritjen e efikasitet të luftës kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe kimit ekonomiko - financiar.
- ✓ Projekti është zhvilluar në periudhën Janar 2009 deri Korrik 2011.
- ✓ Në kuadër të projektit u nënshkrua Memorandumi i datës 6 maj 2009 ndërmjet drejtuesve të Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brëndshme, Ministrisë së Financave, KLSH-së, ILDKP-së dhe SHISH dhe u bë e mundur ngritja e funksionimi me sukses i gjashtë Njësive të Përbashkëta Hetimore (Task Forca).

## 2008 – 2010

### *Përfaqësues i institucionit të prokurorisë në Komitetin Drejtues të Projektit PROSECO.*

- ✓ Projekti PROSECO i financuar nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës, është zbatuar nga Këshilli i Evropës (Divizioni i Kimit Ekonomik) dhe Ministria e Drejtësisë së Italisë. Përfitues në projekt kanë qënë Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia dhe Kosova. Kohëzgjatja e projektit nga Prilli 2008 deri në Prill 2010.
- ✓ Objektivi kryesor i projektit ka qënë që nëpërmjet mbështetjes së rrjetit të prokurorëve të rajonit të Ballkanit Perëndimor të arrihet fuqizimi i kapaciteteve të vendeve të përfshira për të zhvilluar dhe zbatuar bashkëpunimin në luftën kundër krimeve të rënda, bazuar në acquis e BE-së dhe standarte e praktika të tjera Evropiane e ndërkombëtare.
- ✓ Në kuadër të këtij projekti, ndër të tjera, me 25.01.2010 në Romë, është arritur të nënshkruhet një Memorandum Bashkëpunimi nga Prokurorët e Përgjithshëm të Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Serbisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, në fushën e luftës kundër kimit të organizuar dhe formave të tjera të krimeve serioze.



## 2004 – 2013

### *Përfaqësues i institucionit të prokurorisë në Komitetin Drejtues të Konsorciumit Ndërkombëtar.*

- ✓ Konsorciumi Ndërkombëtar është një grup jo formal, i përbërë nga përfaqësues të organizatave ndërkombëtare donatore, të cilat i ofrojnë asistencë Shqipërisë në fushën e zbatimit të ligjit dhe shtetin e së drejtës, si dhe përfaqësues të institucioneve shqiptare përfituese.

- ✓ Kohëzgjatja e kësaj strukture ka qënë nga viti 2001 deri në vitin 2013.

#### **Misioni i Konsorciumit Ndërkombëtar ka qënë :**

- ✓ Të shërbejë si një forum për dialog me qëllim koordinimin e ndihmës së huaj për Shqipërinë ;
- ✓ Të sigurojë shkëmbimin e hapur dhe aktiv të informacionit, në mënyrë që programet e ndryshme të asistencës të shmangin duplikimin dhe të mbështesin njëri – tjetrin ;
- ✓ Të sigurojë që komuniteti ndërkombëtar të jetë në gjëndje të racionalizojë burimet e konsiderueshme, të cilat jepen për programet e zbatimit të ligjit në Shqipëri ;
- ✓ Të sigurojë ndihmesë teknike në fushën e zbatimit të ligjit për Ministrinë e Brëndshme, Policinë e Shtetit, Prokurorinë e Përgjithshme dhe organet e drejtësisë në përgjithësi.

## 2009 – 2013

Kam dhënë mësim lëndën "Procedura Penale", si pedagog i jashtëm në "Universitetin Amerikan", Tiranë.

## 2010 – 2012

Kam dhënë mësim lëndët "Procedura Penale" dhe "Penale e Posaçme", si pedagog i jashtëm në Universitetin "Kristal", Tiranë.